



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17, 38, 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2024, mori këtë,

V E N D I M PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI

Neni 1

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin “Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve”, në vlerë 43,050,00€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

Neni 2

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

Neni 3

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 143,500.00€, financon shumën 100,450.00€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shumën e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 43,050.00€ apo 30% e vlerës së projektit.

Neni 4

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - kodi i programit 48005.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-400/03-0020875/24
Podujevë, datë; 29 mars 2024

